# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-475424**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rokadë në postet diplomatike në Prishtinë dhe Shkup, Denion Meidani e Petrit Malaj ndërrojnë detyrat |
| ADRESA | `https://albeu.com/lajme/rrokade-ne-postet-diplomatike-ne-prishtine-dhe-shkup-denion-meidani-e-petrit-malaj-nderrojne-detyrat/1029949/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 08:21:30 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 08:16:48 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `b1f7e4e65b62a1ab3be6977aa0f1d2b08a11c2b6ab7cbe6c14a4317ffe1504c3` |
| TEKSTI | `7e36e25ac241f2fe966e76073b27daaa36c527e07266cf839181225740355554` |
| PAMJA | `6c91a792d8aa8c4f58179b6aea51d4d4338fb475a0eb8ed96b8d7f633f1d0380` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b496d0cc88b909d2a929b41517fc7bd23e74cbf752a6f394f64e620b8a154bc7` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f736abde33fe298fdab4b0ac01389ddc82e49c4df4ee1e7f323305e5a671536d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b496d0cc88b909d2a929b41517fc7bd23e74cbf752a6f394f64e620b8a154bc7`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Rokadë në postet diplomatike në Prishtinë dhe Shkup, Denion Meidani e Petrit Malaj ndërrojnë detyrat



Ministri i Punëve të Jashtme, Ferit Hoxha, ka rikthyer në axhendë propozimin për ndryshimin e ambasadorëve shqiptarë në dy vende fqinje të rajonit, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut.

Një anëtar i Komisionit Parlamentar për Punët e Jashtme i tha gazetarit të Top Channel, Muhamed Veliu, se më 9 tetor pritet të zhvillohen në këtë komision dy seanca dëgjimore, të lidhura me një rokadë diplomatike.

Ambasadori aktual i Shqipërisë në Shkup, Denion Meidani, pritet të dëgjohet nga komisioni pasi është propozuar për të marrë drejtimin e ambasadës shqiptare në Prishtinë.

Ndërkohë, Petrit Malaj, i cili prej tre vitesh shërben si ambasador i Shqipërisë në Kosovë, do të paraqesë platformën e tij për postin e ambasadorit në Shkup.

Ende nuk është bërë i ditur relacioni shoqërues i ministrit Ferit Hoxha, ku do të shpjegohej arsyeja e këtij ndryshimi në përfaqësitë diplomatike të Shqipërisë në Prishtinë dhe Shkup.

Ideja për këto lëvizje u bë publike fillimisht në maj, pasi ambasadori Denion Meidani u shfaq në krah të protestave studentore në Shkup.

Pas kësaj, u raportua se ministri Ferit Hoxha kishte marrë ankesa nga partia qeverisëse VMRO dhe nga aleati i saj shqiptar, VLEN, lidhur me qëndrimet dhe rolin e Meidanit gjatë protestave.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme i mohoi këto raportime, duke i cilësuar pretendimet si plotësisht të pabazuara.

Në reagimin e saj për mediat, ministria deklaroi se emërimet dhe lëvizjet diplomatike vendosen në përputhje me



Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

legjislacionin në fuqi. Sipas saj, këto procese mbështeten në vlerësime profesionale dhe institucionale, me qëllim përdorimin sa më efikas të burimeve njerëzore dhe zbatimin e prioriteteve të politikës së jashtme shqiptare.

Ndryshimet e mundshme në Prishtinë dhe Shkup nuk janë të vetmet lëvizje që po shqyrtohen në shërbimin diplomatik shqiptar.

Javën e kaluar, Komisioni Parlamentar për Punët e Jashtme zhvilloi seancën dëgjimore me ambasadorin e Shqipërisë në Londër, Uran Ferizi, i propozuar për të drejtuar Misionin e Shqipërisë në OSBE, në Vjenë.

Ndërkohë, ende nuk është përcaktuar emri i ambasadorit të ri shqiptar në Britaninë e Madhe.

Shtuar më 28.09.2026 10:16


Rreziku po shtohet"/ Shërbimi danez i inteligjencës paralajmëro…


Arresti i Vlora Hysenit/ Mbyllet mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare!…


Zjarri shkrumboi lokalin në Athinë ku u vra Pëllumb Islami, banorët u evakuu…


Zjarr shkatërron lokalin në Athinë ku u ekzekutua Pëllumb Islami, policia…


Trump hedh poshtë ofertën e Iranit për Ngushticën e Hormuzit, Brent kapërcen…


Tubimi Kombëtar siguron për herë të parë grup parlamentar në Senatin…


Mustafa Nano: Rama nuk i duron dot personat me integritet, ka një shije të…


Rikthehet "diplomacia e pandave" në SHBA, dy panda kineze mbërrijnë n…


© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko... Kërko

**Kryesore**
Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

**Kategori**
Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

**Linqet**
Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

**Tags**
Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

**Moti**
Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.